



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturorë
Savet Kosova za Kulturno Nasledje / Kosovo Council for the Cultural Heritage

Nr. 005/16
Datë: 06.10.2016

Bazuar në nenin 9 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit për Trashëgimi Kulturorë, nenin 4.1 të Rregullores 01/2016 për Punën e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, nenet 2.18, 2.19 të Rregullores 02/2016 për Vlerësimin dhe Shpalljen e Trashëgimisë Kulturorë në Mbrojtje të Përhershme, nenet 4.4, 4.5 dhe 4.6 të Rregullores 05/2005 mbi Regjistrimin, Dokumentimin, Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Trashëgimisë Kulturorë për Mbrojtje, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, pasi shqyrtoi propozimin e asetit të trashëgimisë kulturore **“Lokaliteti arkeologjik i Dresnikut”** nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në mbledhjen (sesioni) e datës 06.10.2016, merr:

V E N D I M

1. S H P A L L në mbrojtje të përhershme asetit e trashëgimisë kulturore arkeologjike **“Lokaliteti arkeologjik i Dresnikut”** me numër unik TKRKS2A005, bazuar në kriteret dhe vlerat arkeologjike, historike, artistike dhe shkencore.
2. **“Lokaliteti arkeologjik i Dresnikut”** shtrihet në fshatin Dresnik (Nërvadë) komuna e Klinës, zona kadastrale Klinë, me perimetër 16.72 Ha dhe zonë rrethuese 64.15 Ha, sipas hartës së bashkangjitur me koordinata gjeografike, përbën asetit e shpallur në kuadër të kategorisë trashëgimi arkeologjike.
3. MKRS obligohet që të përfshijë në listën e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme asetit e shpallur me këtë vendim.
4. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që brenda afatit gjashtë (6) muajsh të hartojë planin e administrimit – menaxhimit për asetit e lartcekur.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetar i KKTK
Shafi Gashi

Ky vendim i dërgohet:

- Ministrinë të Kulturës, Rinisë dhe Sportit
- Arkivit të KKTK

